



VENDIM

Nr.14 Date 06.03.2009

**PER
FILLIMIN E PROÇEDURAVE TE SHQYRTIMIT TE APLIKIMIT
PER LICENSE TE SHOQERISE “WONDER POWER” SH.A NE
AKTIVITETIN E TREGTIMIT TE ENERGJISE ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 13 pikat 1, germa d, dhe 8 pika 2, germa a, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 10, pikat 1, dhe 3 të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit te plote /te pjesshem dhe rinovimit te licensave ”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108 datë 09.09.2008, dhe nenit 18, pikat 1, gërma a, dhe 3, të “Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerve, Nr.44, date 24.07.2007, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 06.03.2009, mbasi shqyrtoi kerkesen e shoqërisë “Wonder Power” sh.a për fillim te procedurave per licensim ne aktivitetin e tregtimit te energjise elektrike,

Dhe Konstatoi se :

Aplikimi i shoqërisë Wonder Power sh.a ploteson kerkesat e parashikura nga ERE ne rregulloren per procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit te plote /te pjesshem dhe rinovimit te licensave si me poshte:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germa a, b dhe c) eshte paraqitur dhe plotesuar ne menyre korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronesor (neni 9, pika 2, germa a,b,c,d,f dhe g) eshte paraqitur dhe plotesuar ne menyre korrekte.
- Dokumentacioni finaciari dhe fiskal (neni 9, pika 3, germa a, b dhe d) jane paraqitur dhe plotesuar ne menyre korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10) eshte paraqitur dhe plotesuar ne menyre korrekte.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
Bordi i Komisionereve



Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licensë të shoqërisë “Wonder Power” sh.a. në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike.
2. Drejtorja e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Bujar NEPRAVISHTA



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
Bordi i Komisionereve



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

VENDIMIN

Nr.14 Date 06.03.2009

PER
FILLIMIN E PROCEDURAVE TE SHQYRTIMIT TE APLIKIMIT
PER LICENSE TE SHOQERISE "WONDER POWER" SH.A NE
AKTIVITETIN E TREGTIMIT TE ENERGJISE ELEKTRIKE

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
Bujar Nepravishta	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Ardian Haçi	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Shkelqim Bozgo	_____	_____